



## KOMUNA E GOSTIVARIT

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 141,142 të Ligjit për mbrojtje sociale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 79/2009, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164 /13 , 187/13, 38/14, 44/14, 116/14, 180/14, 33/15, 72/15, 104/15, 150/15, 173/15, 192/15, 30/16 , 163/17 dhe 51/18), neni 24 dhe neni 50 paragrafi (3) i ligjit për preventivë, parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 24, datë 29.1.2021), Rregulloren për mënyrën e vlerësimit të rrezikut serioz për jetën dhe integritetit fizik dhe mendor të viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj dhe rrezikun e përsëritjes së dhunës, menaxhimin e duhur të rrezikut, zbatimin dhe monitorimin e masave për mbrojtjen e grave viktime të Dhunës me bazë gjinore dhe viktimat e dhunës në familje, të marra nga qendra për punë sociale (240/21) Komuna e Gostivarit shpall:

### THIRRJE PUBLIKE

**Për grumbullimin e propozimeve për projekt iniciativë për Themelimin dhe fillimin e punës së institucionit për mbrojtje sociale “Qendra për përkujdesje dhe mbrojtje të viktimave të dhunës në familje në Komunën e Gostivarit”**

Komuna e Gostivarit shpall Thirrje publike për grumbullimin e propozimeve për projekt iniciativë nga organizatat qytetare lokale dhe fondacionet me qëllim të realizimit të projektit për trajtimin e problemit të viktimave të dhunës në familje, gjegjësisht themelimin dhe fillimin e punës së një institucioni për mbrojtje sociale të viktimave të dhunës në familje në Komunën e Gostivarit.

Projekti do të realizohet në bashkëpunim partneriti ndërmjet Komunës së Gostivarit dhe organizates qytetare që do të përzgjidhet nga ana e komisionit pas përfundimit të afatit për aplikim të thirrjes publike .

Për këtë qëllim, në Programin për aktivitetet e Komunës së Gostivarit në sferën e mbrojtjes sociale, shëndetësore dhe të fëmijëve në vitin 2023, AE-programi - **Shpenzime kapitale prej 1.200.000,00 denarë** janë planifikuar për hapjen e qendrës për gra dhe vajza viktime të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, këto mjete janë në dispozicion si pjesëmarrje komunale e mjeteve financiare të nevojshme për realizimin e projektit “Themelimi dhe fillimi i punës së institucionit Qendër për kujdes dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje në komunën e Gostivarit”

#### **Të drejtë për pjesëmarrje:**

Të drejtë pjesëmarrje në thirjen publike me propozim projektet e tyre kanë të gjitha subjektet juridike qofshin Shoqatat qytetare ose Fondacione me seli në Komunën e **Gostivarit** si komunë amë ku do të realizohet fizikisht projekti, të regjistruara në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

#### **Vlera e projekteve që do të financohen**

Vlera e projektit përcaktohet midis partnerëve, edhe atë: 1.200.000,00 denarë të ndarra nga buxheti komunal, mjete financiare të planifikuara në programin për aktivitetet e Komunës së Gostivarit në fushën e mbrojtjes sociale, shëndetësore dhe të fëmijëve në vitin 2023 si dhe pjesa tjetër e mjeteve do të sigurohet nga Shoqata qytetare ose Fondacioni që do të shpallet fituese nga komisioni pas përfundimit të thirrjes publike.



## **Kriteriumet që duhet të plotësojnë dorëzuesit e propozim- projektit (aplikantit)**

- **Kriteret bazë që duhet të plotësojnë Shoqatat dhe Fondacionet pjesëmarrëse në këtë thirrje janë:**

- Shoqatat dhe fondacionet që do të aplikojnë në thirrjen publike të jenë të regjistruara në pajtim me Ligjin për shoqata dhe fondacione të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

- Shoqatat dhe fondacionet që do të aplikojnë në thirrjen publike të jenë të regjistruara në territorin e Komunës së **Gostivarit**;

- Realizimi i programeve të Shoqatave dhe fondacioneve që do të aplikojnë në thirrjen publike duhet të jenë në kuadër të Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut,

– Shoqatat dhe fondacionet që do të aplikojnë në thirrjen publike, propozim projektet e tyre duhet të implementohen/realizohen vetëm në territorin e Komunës së Gostivarit;

- Shoqatat dhe fondacionet që do të aplikojnë në thirrjen publike duhet të kenë në dispozicion resurse teknike njerëzore dhe hapësinore në përputhje me Ligjin për mbrojtjen sociale, Rregulloren për normat dhe standardet për themelimin dhe fillimin e punës për Institucionet e mbrojtjes sociale, Qendrat për viktima të dhunës në familje dhe Rregulloren për normat dhe standardet e hapësirës, pajisjeve, kuadrit profesional dhe mjeteve të nevojshme për themelimin dhe fillimin e punës së institucionit për mbrojtje sociale – këshillimore për kryesit e dhunës në familje (G.Z. e RMV-së nr. 69/12)

- Shoqatat dhe fondacionet që do të aplikojnë në thirrjen publike, duhet që vet të sigurojnë hapsirat për ushtrimin e veprimtarisë së qendrës për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

- **Kriteret e veçanta që duhet të plotësojnë Shoqatat dhe Fondacionet të cilat marrin pjesë në këtë thirrje janë:**

- Shoqata dhe fondacionet që do të paraqiten si aplikantë duhet të ketë dëshmi për pjesëmarrje financiare të vlerës totale të projektit përpos mjeteve financiare që sigurohen nga buxheti komunal i Komunës së Gostivarit (vlera e të cilëve shtet 1.200 000,00 den).

- Propozimi projektet/aktivitetet duhet të dorëzohen në bazë të udhëzimeve dhe formularëve që janë të parashtruara dhe përmendura në thirrjen publike;

- Mjetet e alokuara do të përdoren ekskluzivisht për qëllimin për të cilin janë dedikuar dhe sipas udhëzimeve të përcaktuara në thirrjen publike (Formulari i Aplikimit/Fletëparaqitja, Korniza logjike, Plani i aktiviteve/ vizibiliteti-promovimi i projektit dhe Formulari për Buxhetin e Projektit)- komponentët e aplikacionit;

- Në dokumentet e aplikimit (formularin/aplikacionin dhe buxhetin e projektit) është e detyrueshme të tregohet bashkëfinancimi (pjesëmarrja vetanake) nga aplikanti.

## **Dokumentacioni i nevojshëm që Shoqata ose Fondacioni duhet t'ia bashkangjesin Fletëparaqitjes.**

Në kuadër të dokumenteve bazë, krahas fletëparaqitjes, (shoqata e qytetarëve ose fondacionet) e cila duhet të jetë e plotësuar me shkronja të shtypit me shkrimi latin, e nënshkruar nga përfaqësuesit e shoqatave dhe fondacioneve, e vërtetuara me vulë dhe stembil, e përgatitura sipas udhëzuesit të dhënë në



thirrjen publike, aplikantët që i përgjigjen thirrjes publike duhet të dorëzojnë edhe ANEKSET e mëposhtme:

**Dokumentet bazë:**

**Aneksi 1:** Fletëparaqitja

**Aneksi 2:** Pasqyra e buxhetit/ Formulari për pasqyrë të buxhetit të projektit-aktivitete e projektit

**Aneksi 3:** Korniza logjike

**Aneksi 4:** Plani i aktiviteteve dhe dukshmëria/promovimi

**Aneksi 5:** Formulari me të dhënat administrative për aplikantin

**Aneksi 6:** Formulari me të dhënat financiare për aplikantin

**Aneksi 7:** Deklarata për përshtatshmëri

**Aneksi 8:** Lista e verifikimit

**Dokumentet shtesë:**

1. Statusi aktual i shoqatës së qytetarëve /fondacionit jo më i vjetër se 6 (gjashtë) muaj;
2. Kopje e vërtetimit/aktvendimit të vlefshëm për regjistrimin e shoqatës së qytetarëve/fondacionit në vendin tonë (për bartësin e projektit/aplikantin dhe partnerët eventuale).
3. Kopje e statutit të shoqatës së qytetarëve / fondacionit (parashtruesit dhe partnerëve).
4. Kopja e raportit financiar vjetor përfundimtar për vitin paraprak/llogarinë përfundimtare (pasqyra e të ardhurave dhe bilanci) e vërtetuar nga institucioni kompetent për punë financiare ose kontabilist i autorizuar, përveç nëse shoqata e qytetarëve/fondacioni është themeluar në vitin aktual.
5. Profili i shoqatës së qytetarëve / fondacionit me listën e projekteve të realizuara në vitet e mëparshme.
6. Programi vjetor i aktiviteteve për vitin 2023



**Aplikantët të cilët paraqiten në thirrjen publike patjetër duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kompletuar!**

### **Paralajmërim!**

Dokumentet bazë janë në dispozicion dhe mund të shkarkohen në ueb-faqen e Komunës së Gostivarit ([www.gostivari.gov.mk](http://www.gostivari.gov.mk)) ku është e publikuar edhe Thirja Publike. Dokumentet duhet të plotësohen sipas Udhëzimeve. Dokumentat e kompltuara duhet të jen të plotësuara tërësisht, të firmosura nga Kryetari i shoqatës, të verifikuara me vulën dhe stembilin e organizatës, ku aplikantët të gjithë dokumentacionin si parashtrësë në formën e printuar në letër dhe një kopje në formë elektronike, (CD ose USB) e dorëzojn në komunë.

### **Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit të Projektit**

Dokumentet bazë dhe dokumentet shtesë të detyrueshëm duhet të dorëzohen në dy kopje origjinale, një në formë të shtypur dhe një në formë elektronike në CD ose USB të kompletuara të vendosura në plikë, si parashtrësë, dorëzohen direkt nga personat e autorizuar të aplikuesëve ose përmes postës në **Arkivin e Komunës së Gostivarit në adresën e mëposhtme: Komuna e Gostivarit, Departamenti i Mbrojtjes Sociale, Shëndetësore dhe të Fëmijëve, rruga -Blvd. B. Gjinoski 61, 1230 Gostivar, RMV, në ditë pune (nga e Hëna në të Premte), nga ora 08:00 deri në ora 16: 00, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e shpalljes së Thirrjes Publike.**

**Dokumentacioni duhet të vendoset në një zarf të mbyllur dhe në të të shënohet:**

“ THIRRJE PUBLIKE”

Për grumbullimin e propozimeve për projekt iniciativë për Themelimin dhe fillimin e punës së institucionit për mbrojtje sociale “Qendra për përkujdesje dhe mbrojtje të viktimave të dhunës në familje në Komunën e Gostivrit”

**Në pjesën e përparme të zarfit Në këndin e sipërm majtas duhet të shkruhet: "Mos hap", dhe në këndin e poshtëm djathtas duhet të shkruhet:**

Komuna e Gostivarit

Departamenti i Mbrojtjes Sociale, Shëndetësore dhe të Fëmijëve

Blvd. B. Gjinoski 61,



1230 Gostivar, RMV

**Afati për dorëzimin e aplikacioneve (dokumentacioni i kompletuar) është pesëmbëdhjetë (15) ditë, nga dita e shpalljes së Thirrjes Publike, nga data: 10.07.2023( E Hënë) deri më 28.07.2023(E Premte)**

### Vërejtje

**Aplikimet me dokumentacion të pakompletuar ose të pranuar pas afatit të fundit për aplikim nuk do të merren parasysh. Aplikimet që mbërrijnë me postë pas afatit do të merren parasysh vetëm nëse vula postare tregon datën jo më vonë se afati i fundit i Thirrjes Publike. Dokumentacioni i pranuar nuk kthehet!**

**Rezultatet e Thirrjes publike do të shpallen në faqen zyrtare të Komunës së Gostivarit. [www.gostivari.gov.mk](http://www.gostivari.gov.mk)**

**Pyetjet për sqarime plotësuese mund të dorëzohen me shkresë ose në formë elektronike deri tek Komisioni për realizimin e Thirrjes publike [www.gostivari.gov.mk](http://www.gostivari.gov.mk) , [info@gostivari.gov.mk](mailto:info@gostivari.gov.mk) , tel. +389 (0) 42 213 511, fax. +389 (0) 42 214 406 .**

**Personi për kontakt: Imerlije Saliu-Fetai, [i\\_saliu@yahoo.com](mailto:i_saliu@yahoo.com) , <tel:070/781-396> Departamenti i mborjtjes sociale, shëndetësore dhe të fëmijëve /Komuane Gostivarit**

**Kryetari i  
Komunës së Gostivarit  
Arben Taravari**

